

MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA E FINANCËS

RAPORTET E MONITORIMIT

3 - MUJORI - VITI 2016

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË TRE MUJORIT TE PARE TE VITIT 2016**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 147 dt 17.12.2015, “Për Buxhetin e vitit 2016”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016” paragrafi IV “Monitorimi” Ministria e Kulturës, për 3- mujorin e parë të vitit 2016, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për **3 - mujorin e parë të vitit 2016**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 3– mujori I 2016		Realizimi 3– mujori I 2016		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	33,012	7.8%	25,465	9.5%	7.7 %
2.	Trashegimia Kulturore	133,167	31.8%	85,196	31.9%	63.9%
3.	Arti dhe Kultura	252,059	60.2%	156,309	58.5%	62%
	Totali	418,238	100%	266,970	100%	63.8%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	418,238	100%	266,970	100%	63.8%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti është realizuar në masën 64%, ku rreth 60 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 62 %, ndjekur nga programi "Trashegimia Kulturore dhe Muzete’ shpenzimet e të cilit zënë rreth 32 % dhe janë realizuar në masën 64 % dhe programi "Planifikim Menaxhimi Administrim’ shpenzimet e të cilit zënë rreth 8% të totalit dhe janë realizuar në masën 8%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori I 2016		Realizimi 3-mujori I 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12		600-601	Paga, Sig.Shoq	221,435	52.9%	210,313	78.8%	95%
12		602-606	Shpen.Korrente	98,775	23.6%	56,657	21.2%	57.4%
12		231	Kapitale	98,028	23.4%	0	0%	0%
			TOTALI	418,238	100	266,970	100	63.8%
12		231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	418,238	100	266,970	100	63.8%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 3-mujorin e parë të vitit 2016 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 95%, shpenzimet korente 57 %, dhe shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 0%.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 36.2% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve kapitale.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3- mujori I 2016		Realizimi 3- mujori I 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	20,767	62.9%	19,295	75.8%	92.9%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	9,745	29.5%	6,170	24.2%	63.3%
12	01110	231	Kapitale	2,500	7.6%	0	0%	0%
			TOTALI	33,012	100	25,465	100	77.1%

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 77%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 63% të totalit dhe janë realizuar në masën 93%. Shpenzimet korrente zënë rreth 30% të totalit dhe janë realizuar në masën 63%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 8% të totalit dhe janë realizuar në masën 0%. Mosrealizimi i fondeve në masën 22.9% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale. Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 3-mujori I 2016	Buxhet/Fakt 3-mujori i 2016
G-00323	Pajisje dhe punime ne ambjentet e MK	10,000	10,000	2,500	-
H-00323	Mbeshtetja ligjore e te gjitha aktivitetet te MK ne perputhje me programin e qeverise	12,982	12,982	3,256	2,582
I-00323	Menaxhim me efektivitet I burimeve njerezore dhe financiare per realizimin e objektivave	58,898	53,898	13,485	12,118
J-00323	Permbushje e detyrimeve financiare-ligjore	17,535	17,535	4,384	3,173
K-00323	Kontrolli i zbatimit me perpikmeri te legjislacionit te fushes	14,566	14,566	3,642	2,880
L-00323	Intensifikimi i bashkepunimit rajonal dhe nderkombetar	22,985	22,985	5,745	4,712
	Totali	136,966	131,966	33,012	25,465

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi. Për tre mujorin janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e MK-së.

Për sa i përket produktit “Pajisje elektronike dhe elektrike” gjatë kësaj periudhe nuk ka patur blerje të pajisjeve kompjuterike elektrike gjithashtu dhe blerje pajisje zyrash.

Në realizimin e Produktit “Pagesa vendimesh gjyqësore” gjatë kësaj periudhe ka patur likudim të vendimeve gjyqësore, kryesisht vetëm për Z. Esat Ruka.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2016 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nënligjore”, janë planifikuar akte ligjore dhe nënligjore përmendim këtu projektligjin: Ligjin nr. 10352 dt. 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën”, “Për pensionet e artistëve”, Për Trashëgiminë Kulturore” dhe disa VKM:

- 1.Ligj Nr. 35/2016 “Per te drejtat e autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me to”.
 - 2.Per shpronësimin per interes publik, te pasurise prone private qe preket nga zbatimi i projektit “ Rindertimi i baneses ku u ngrit flamuri Korce” te miratuar me vendim te Keshillit Kombetar te Restaurimeve nr.16 date 30.05.2014
 - 3.Projektvendim per krijimin e Muzeut te Fotografise “Marubi” dhe ndryshimin e pergjegjesise se administrimit te godines e te mjeteve kryesore te fototekes “Marubi” nga ministria e Kultures te ky muze.
 4. Per levizjen jashte territorit te Republikes se Shqiperise te 65 veprave te artit ne Poster te artistit hungarez, Peter Pocs pjese fondit te Galerise Kombetare te Arteve, te cilat do te ekspozohen ne Galerine Kombetare te Arteve te Kosoves, Prishtine.
 5. Per kalimin ne pergjegjesi administrimi , nga Albafilm Sh.a te Ministria e Kultures e objektit “ Ish-Laboratori i Filmit” ne zonen kadastrale 8130, dhe per nje shtese fodni ne buxhetin e vitit 2016, miratuar per Ministrine e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregetise dhe Sipermarrrjes.
 - 6.Per shpronësimin, per interes publik , te pronarit te pasurise se paluajtshme, prone private, qe preket nga zbatimi i “ Rikostruksioni dhe ndryshimi i destinacionit te ish-labororit hidraulik ne qender arti-Skena e re”
 7. Per dhenie pensioni te posacem familjareve ne ngarkim te te ndjerit Florjan Kondi.
 8. Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1197, dt.03.12.2009, te Keshillit te Ministrave, “Per shpalljen e Kalase se Tiranes zone arkeologjike A’ dhe miratimin e rregullores per administrimin e saj”.
 9. Per nje ndryshim ne vendimin nr.238, dt.23.03.2011 “ te Keshillit te Ministrave “ Per shpalljen e qendres historike te qytetit te Korces dhe miratimin e rregullores se saj”.
 10. Programi i pergjithshem analitik te projektateve te Ministrise se Kultures per vitin 2016 (PPAA2016)
- Në realizimin e Produktit “Pagesa vendimesh gjyqësore” gjatë kësaj periudhe ka patur likudime të vendimeve gjyqësore, përmendimin likuidimin për Arlind Patozin, për Shoqërinë Plejad, për Klodian Mamica etj.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjes”, Brenda këtij 3-mujori nuk ka marrëveshje/programe bashkëpunimi të miratuara.

Marrëveshje/Programe te hartuara në proces

1. Deklarate/Protokoll Bashkëpunimi Kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Komunikimit të Republikës Franceze dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë.
2. Program Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës Popullore të Kinës për periudhën 2016-2020
3. Program Bashkëpunimi Kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës së republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Kroaci 2016-2019.
4. Program Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së kulturës së Federatës Ruse për periudhën 2016-2018.
5. Program Bashkëpunimi Kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare të Republikës së Polonisë dhe Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisëpër periudhën 2016-2019.

Marreveshja me Bullgarinë , lider është Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Nenshkrimi varet nga ata. Ne i kemi perfunduar proceduart per propozimet.

6. Rinovimi i “Programit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për Bashkëpunimin në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës, për periudhën 2012-2014 të zgjatet për periudhën trevjeçare (2015-2017).

Në realizimin e Produktit “Auditime” vazdojnë të auditohen, janë në proces disa institucione si ZSHDA, IMK etj.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2016		Realizimi 3– mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08220	600-601	Paga, Sig.Shoq	68,558	51.5%	64,367	75.6%	93.9%
12	08220	602-606	Shpen.Korrente	34,309	25.8%	20,829	24.4%	60.7%
12	08220	231	Kapitale	30,300	22.8%	0	0%	0%
			TOTALI	133,167	100%	85,196	100%	64%
12	08220	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	133,167	100%	85,196	100%	64%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 64%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 52 % të totalit dhe janë realizuar në masën 94%, shpenzimet korrente zënë rreth 26% të totalit dhe janë realizuar në masën 61 % dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 23% dhe janë realizuar në masën 0 %.

Mosrealizimi në masën 36 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet korrente dhe kapitale. Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë				08220
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 3-mujori 2016	Buxhet/Fakt 3-mujori 2016
N-00324	Elemente te trashegimise materiale e jomateriale te inventarizuara ne menyre	20,408	20,408	2,868	2,318

MINISTRIA E KULTURËS

	dixhitale				
P-00324	Akte nenligjore te Ligjit te ri per Trashegimine Kulturore te hartuara dhe miratuara	6,854	6,854	-	-
S-00324	Monumente te restauruara dhe mirembajtura ne gjithe vendin	180,579	224,379	48,716	42,469
T-00324	Muze dhe parqe arkeologjike me infrstrukture te permirsuar per te ofruar sherbim cilesor ndaj vizitoreve	161,847	161,847	40,470	33,187
U-00324	Aktivitetet te trashegimise materiale, jomateriale dhe te diversitetit kulturor te organizuara ne rang vendi	34,871	34,871	10,813	7,222
V-00324	4 Monumete kulture te restauruara (aparati MK)	89,200	122,233	25,270	-
	Krijimi i Qendrave te informimit public per rregjistrimin on-line te Pasurive Kulturore		23,167	5,030	-
	Totali	493,759	593,759	133,167	85,196

1. Elemente te trashegimise materiale e jomateriale te inventarizuara ne menyre dixhitale

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, gjatë vitit 2016 në kuadër realizimit të objektivave lidhur me inventarizimin dhe katalogimin e pasurive kulturore kryen inventarizimin dhe katalogimin e objekteve të institucioneve Publike , objekte të institucioneve kombëtare dhe objekte të institucioneve lokale.

QKIKP në kuadër të projektit të përditësimit të listës së monumenteve dhe standardizimit të formatit të dokumentimit ka hedhur në sistem 6359 kartela të institucioneve kombëtare, kartela për Objekte shpallje mon.kateg I, kateg II, miratim projekt restaurimi, pajisje me licence, shpallje zonë e mbrojtur etj.

- **Muze dhe parqe arkeologjike me infrastrukturë të përmirsuar për të ofruar shërbim cilesor ndaj vizitorëve,**

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”.

Përfundimi i Ndërtesës së re dhe Muzealizimi i Muzeut të Fotografisë “Marubi” i cili do të hapet për publikun më datë 9 maj 2016. Pas përfundimit të restaurimit të plotë të godinës së blerë nga Ministria e Kulturës po punohet intensivisht për realizimin e muzealizimit të muzeut si dhe hapjen e tij për publikun.

Gjithashtu është drejt finalizimit faqja eeb lidhur me promovimin dhe prezantimin e arkivit fotografik Marubi duke paraqitur një rrugëtim pamor të historisë së fotografisë shqiptare.

Muzealizimi i Muzeut të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”.

Pas Restaurimit apo reabilitimit të plotë të godinës po vazhdon puna për muzealizimin e tij. Po punohet në disa drejtime, si me kuratorët, hartuesit e projektit të Muzealizimit si dhe vazhdon puna për zbatimin e projektit të muzealizimit. Po punohet intensivisht dhe për përzgjedhjen, restaurimin, rregjistrimin e objekteve që do të ekspozohen. Ky muze është një nga prioritetet kryesore të MK dhe parashikohet të hapet për publikun në dhjetor 2016.

Godina e re e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë. Ndërtesa e re e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë, apo «Qendra për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore» ku do të zhvendoset Muzeu i sotëm Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë me të gjithë objektet e ekspozuara, fondin dhe funksionet e tij administrative dhe restauruese, ka nisur që në vitin 2008. Aktualisht, ka përfunduar puna për ndërtimin e godinës. Zhvendosja e fondeve pritet të fillojë në gjysmën e dytë të vitit 2016. Po punohet për hapjen e muzeut brenda vitit 2016.

Muzeu Arkeologjik, Durrës, Vazhdon puna për muzealizimin e katit të dytë dhe të tretë. Po hartohet projekti i muzealizimit dhe do të vazhdojnë procedurat për realizimin e tij.

Parqet arkeologjike kryejnë në vijimësi:

- Restaurim, konservim dhe mirëmbajtjen e strukturave arkitektonike dhe arkeologjike
- Mirëmbajtjen e territorit, pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët
- Organizim i aktiviteteve kulturore me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditave lokale, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit dhe nxënësve të shkollave të sistemit parauniversitar.
- Parqet Arkeologjike si pasojë edhe e përmirësimeve në vijimësi në infrastrukturë organizojnë aktivitete që kontribuojnë në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditave lokale dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve vendase.

Në PA Apoloni me Financime të huaja po realizohet:

- Projekti “Rehabilitimi i Manastirit të Shën Marisë për përdorim muzeal dhe peisazhit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë”, Fier në kuadër të financimeve IPA.
- Kanë filluar punimet, është realizuar, kabina elektrike, depo e ujit dhe aktualisht po punohet në portik. Punimet janë realizuar në masën 10 % .

3. Monumente të restauruara dhe mirëmbajtura në gjithë vendin

Në përmbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës: “Të ruajë, mbrojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Trashëgiminë dhe Diversitetin Kulturor gjatë vitit 2016 i kushton vëmendje të veçantë Rehabilitimit të Monumenteve të Kulturës për t’i shndërruar ato në produkte turistike kulturore. Në vazhdim të eksperiencës së vitit 2015 në menaxhimin e fondeve për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, janë marrë masat për përdorimin me efektivitet të këtyre fondeve me synim mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës nëpërmjet konservimit, konsolidimit, restaurimit të tyre.

Janë kryer punime mirëmbajtje, konsolidimi pastrim vegjetacioni dhe restaurimi apo janë duke u kryer punime në rreth 29 Monumente Kulture nga DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë. Po përgatiten objektet e trashëgimisë kulturore për sezonin turistik, vazhdon mirëmbajtja rutinë e tyre si dhe mbrojtja nga dëmtimet dhe degradimi nga agentët atmosferikë. Sipas Institucioneve janë kryer punime nga:

- **DRKK Durrës** ka kryer punime mirëmbajtje, pastrime nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë dhe ndërhyrje restauruese në objekte Monument Kulture, janë kryer punime restauruese Pastrime dhe mirembajtje ne Kishen e Gjon Pagezorit ne fshatin Derven ne Kruje, Pastrime dhe mirembajtje ne Mozaikun e Tiranës, Pastrime dhe mirembajtje ne Amfiteater, Pastrime nga vegjetacioni në Kalanë e Elbasanit, Pastrimi dhe mirembajtje ne monumentin e Hamamit Mesjetar në Durrës për realizimin e aktiviteteve nga Shkolla Jan Kukuzeli, Pastrime dhe mirëmbajtje në Muret Rrethuese të qytetit të Durresit, Pastrime dhe mirëmbajtje në Macellum Forum (Rotonda), Pastrime dhe mirëmbajtje në Banesen Aleksandër Moisiu, etj.
- **DRKK Berat**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit ka kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtëse, konsolidime, pastrime nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë, në objekte monument kulture kështu:
Restaurimi i murit kufizues pranë kullës nr. 14 në Kala, Berat ,Ndërhyrje restauruese në çatinë e Kishës së Shën Triadhës, Kala, Punime mirëmbajtje dhe pastrimi nga mbetjet urbane, inertet dhe nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët jashtë murreve perimetrale në lagjien Kala, Pastrim nga vegjetacioni dhe punime mirëmbajtje dhe pastrimi të ambjentit të jashtëm dhe të brendshëm në 3 lagjet e Qendrës Historike.
- **DRKK Korçë**, ka kryer punime mirëmbajtje, restauruese, konsolidim në Kishën e Shën Thanasit, Voskopojë. Punime mirëmbajtje dhe pastrimi ne Voskopoje , Vendosje sinjalistike në Voskopojë.
- **DRKK Gjirokastrë**, ka kryer punime mirëmbajtje në objekte monument kulture Restaurim porte I banesës STAVRI Katg.II, Restaurim i fasadas ballore të banesës "Beqiri" katg.I, Ndërhyrje përforcuese në çatinë në Pazar (Shehu), Ndërhyrje përforcuese në dyshtemenë e banesës "Ciu" ,restaurim i ballit të banesës, Ndërhyrje restauruese në çati në Pazar(Kodra),Ndërhyrje restauruese në çati në Pazar(në krah të zyrave tona), etj.
- **DRKK Vlorë**, u kryen punime mirëmbajtje Pastrimi dhe sistemimi i territorit në *Xhamia e Muradies, P.A.Amantia,P.A.Orik, P.A.Finiq.*
- **DRKK Shkodër**, u kryen punime mirëmbajtje në *Kalanë e Shkodrës dhe Kalaja e Drishtit*, punime pastrimi nga bimësia.

4. Aktivitete te trashëgimise materiale, jomateriale dhe te diversitetit kulturor te organizuara ne rang vendi

Në vijim të thirrjes për aplikim të shpallur nga Ministri i Kulturës për financim dhe mbështetje me fondet publike të projekteve në fushën e art-kulturë-trashëgimi, u miratuan Aktivitete te trashëgimise materiale, jomateriale dhe te diversitetit kulturor që do të organizohen në rang vendi. Do të zhvillohen aktivitete të mbështetura nga programi trashëgimia kulturore:

Festivali Oda Dibrane, Festivali i 13-të mbarëkombëtar i instrumentistëve të vegjël popullorë, Fush Arrëz, Përmeti multikulturor, Aulona interfolk Festival, etj.

Në kuadër të përfaqësimit të Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës në Venecia, 28 Maj - 27 Nëntor, 2016, vazhdojnë përgatitjet për përfaqësim sa më dinjitoz.

Vazhdon puna për realizimin e një sërë aktiviteteve me rastin e 18 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve”.

- Edukimi mbi/përmes trashëgimisë dhe nisma “Miq të Monumenteve”.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit mes DRKK-ve dhe DAR mundësojnë një bashkëpunim të ngushtë me specialistëve të DRKK dhe mësuesve të lëndëve të ndryshme të trajnuar tashmë në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore. Nismat rajonale variojnë nga “birësimi” i monumentit nga shkolla të caktuara deri tek studimi i historisë së tij, organizimi i fushatave të pastrimit nën kujdesin e Drejtorive Rajonale të Monumenteve të Kulturës.

7. Krijimi i Qendrave të informimit publik për regjistrimin on-line të Pasurive Kulturore

Në kuadër të Programit “Shqipëria dixhitale”- Ministria e Kulturës me Fondin për Zhvillimin e Rajoneve 2015-2016 po realizon projektin “Krijimi i Qendrave të informimit publik për regjistrimin on-line të Pasurive Kulturore” me vlerë totale 45.429.000 lekë.

Objektivi i Përgjithshëm i projektit është Krijimi i një Sistemi informatik kombëtar të Administrimit të Trashëgimisë Kulturore ëeb dhe i një database unike për trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve, me qëllim identifikimin, katalogimin, ruajtjen dhe përdorimin e saj. Synimi është realizimi sipas të gjitha standarteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare ku të theksohet aksesin i publikut dhe i institucioneve të interesuara për përdorim të lirë, por të shërbeje dhe si një strategji kombëtare në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurisë kulturore.

- Gjatë vitit 2015 u realizua blerja e paisjeve për realizimin e këtij projekti.
- Në vitin 2016 do të përfundojë i gjithë projekti. Janë përcaktuar zyrtarisht rajonet pranë Drejtorive rajonale të monumenteve të Kulturës dhe po punohet për rikonstruksionin dhe përshtatjen e tyre për funksionin aktual

Rezultatet përfundimtare të këtij projekti:

- Hartimi i databazës kombëtare ëeb
- Përfshirja e QKIPK në netëorëkun rajonal për Qendrat e Katalogimit brenda vitit 2016.
- Krijimi i infrastrukturës teknike dhe profesionale për shërbimin publik të QKIPK në bazë të standarteve ndërkombëtare për informimin e qytetarëve mbi procedurat e regjistrimit dhe mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Shqipëri.
- Krijimin e 6 Qendrave të Informimit Publik për Regjistrimin on-line të Pasurive Kulturore Kombëtare pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare.
- Krijimin e sportelit të shërbimit publik pranë Qendrës Kombëtare të Qendrave të Informimit Publik për regjistrimin On-line të Pasurive Kulturore Kombëtare.
- Sistemi do të mundësojë lidhjen në kohë reale online të këtij shërbimi: me institucionet në sistemin e trashëgimisë kulturore dhe të turizmit, shërbimin doganor të RSh për monitorimin e lëvizjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore që dalin jashtë territorit të Shqipërisë.

- Policinë e Shtetit dhe pikat e kalimit kufitar, për shikëmbim informacioni në system lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Mirëmbatja e sistemit do të bëhet për një periudhë 4 vjecare, viti i parë do të ketë një vlerë 2,495,160 mijë lekë me TVSH, tre vitet e tjera 3,934,402 lekë me TVSH do të sigurohen nga buxheti i shtetit, referuar VKM nr 710 date 21.08. 2013 “ Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit.

2. Programi: “ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 3– mujori 2016		Realizimi 3– mujori 2016		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08230	600-601	Paga, Sig.Shoq	132,110	52.4%	126,651	81%	95.9%
12	08230	602-606	Shpen.Korrente	54,721	21.7%	29,658	19%	54.2%
12	08230	231	Kapitale	65,228	25.9%	0	0%	0 %
			TOTALI	252,059	100%	156,309	100%	62%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 62%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 52% të totalit dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet korrente zënë rreth 22% të totalit dhe janë realizuar në masën 54%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 26% dhe janë realizuar në masën 0%. Mosrealizimi i fondeve në masën 38% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura				08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2016	Buxhet Plan 2016	Buxhet/Plan 3-mujori 2016	Buxhet/Fakt 3-mujori 2016
A-00325	Veprimtari te realizuara ne institucionet e art kultures	636,257	736,256	138,447	118,787

MINISTRIA E KULTURËS

B-00325	Veprimtari te realizuara me fondet e programit art kultures	237,000	237,000	39,500	31,600
C-00325	Perfaqesimi ne programe dhe evenimente nderkombetare	44,418	44,418	8,884	5,922
D-00325	1 qender e re kulturore e krijuar	160,910	160,910	65,228	-
	Totali	1,078,585	1,178,584	252,059	156,309

1- Produktin (A): Veprimtari të realizuara në institucionet e Art Kulturës

1. Në institucionin e TKEKS shfaqen për çdo fundjavë aktivitete teatrore për fëmijë.
2. Nga fondi i thirrjeve për projekte, janë mbështetur rreth 30% e projekteve me fokus edukimin përmes kulturës.
3. Në GKA është krijuar atelieja për fëmijët, në bashkëpunim me FAVA.
4. Realizimi në dy vjet i **Programit Atelieja e Edukimit**, pranë Galerisë Kombëtare të Arteve që konsiston në pjesëmarrjen e lirë në një hapësirë të posaçme e konceptuar si “Atelje”, e cila ka ofruar programe artistike, bisedat me artistë dhe punën e edukatorëve që kanë zhvilluar ëorkshop-e për pjesëmarrësit e të gjitha moshave.

Informacion më i detajuar dhe i specifikuar sipas indikatorëve dhe treguesit përkatës për secilin nga Institucionet e artit dhe Kulturës, bashkëlidhur tabela statistikore për 3 muajt e vitit 2016.

Zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në institucionet kulturore në vend si psh:

1. Rehabilitimi infrastrukturor dhe rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor;
2. Rikonstruksioni e 2 teatrove vendorë si Teatri Andon Zako Çajupi Korçë dhe Teatri Migjeni, Shkodër;
3. Krijimi i Hapësirave të reja qytetare me fokus edukimin përmes kulturës të brezit të ri me destinacion Qendrën Kombëtare Kulturore për Fëmijë, Tiranë.

Ndër të tjera, me realizimin e këtyre investimeve do të mundësohen:

- Krijimi i hapësirve te reja qytetare me kushte optimale dhe standarte europiane;
- Përmirsimi i marrëdhënieve me audiencën (spektatorët) duke rimodeluar volumin dhe lëvizjen;
- Përmirësimin e komunikimit;
- Përmirësimin e sistemeve mekanike, teknike dhe ato të aspirim-kondicionimit për objektet ekzistuese;
- Për të zgjidhur problemet akustike (të vete sallës por edhe ambjenteve të provave) back stage;
- Për të rritur kapacitetin e objekteve;
- Për të rritur konfortin.

Referuar tabelave, me argumentimin se: nuk kane nisur ende procedurat shkresore per levrimin apo çeljen e fonidt me destinacion zhvillimin e infarstruktures dhe sherbimeve ne institucionet kulturore ne vend, me argumentimin se eshte proces tenderi per perzgjedhjen e projektit me te mire (TKOB); Rikonstruksion I objektit te Qendres Komb. Kulturore te femijeve, FZHR(Teatri Korce dhe Teatri Migjeni) jane ne proces realizimi dhe perfundon 31.12.2016

2. Produkti (B): Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë

(Zhvillim të Audiencave dhe Edukim Përmes Kulturës, përmes programeve dhe atelieve të edukimit në Institucionet e artit).

1. 93 projekte fituese në art, kulturë, trashëgimi, mbështetje ndaj sektorëve kreative dhe skenës së pavaruar në art-kulturë.
2. Nënshkrimi Memorandumit të Bashkëpunimit për Edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë, midis MAS dhe MK.
3. Rritja ndjeshëm e numrit të programeve artistike, projekteve kulturore për fëmijë, si dhe pjesëmarrja e shkollave për të marrë pjesë në aktivitetet artistike kulturore në Institucionet e Artit dhe Kulturës.
4. Kanë marrë rrugë projekte dhe programe specifike pilot dhe të qëndrueshme të artit në edukim.
5. Në institucionet e artit, janë finalizuar dhe shpallur publikisht kalendarët e posaçëm të edukimit përmes kulturës.
6. Janë ndërtuar strukturat e edukimit kulturor pranë institucioneve e varësisë.
7. Janë trainuar stafet përkatëse të këtyre strukturave.
8. Nënshkrimi i Protokollit dhe kalendare të përbashkët kulturor Shqipëri – Kosovë; mbi 20 projekte të bashkërenduara midis institucioneve dhe subjekteve të artit dhe kulturës, së dy vendeve.

3. Produkti (C), Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare

(Rritja e bashkëpunimeve dhe përfaqësimeve të artit dhe artistëve shqiptar në evenimente dhe skena ndërkombëtare).

1. Përfaqësimi i Kulturës Shqiptare me Festivalin “Balkan Trafik”, Belgjike Vikena Kamenica, Keli Bank dhe Grupi Ali Pashë Tepelena.
2. Përfaqësimi i Arkivit Qëndror Shqiptar i Filmit në Festivalin Ndeërkombëtar të Filmit Dokumentar “Cinema du Reel, në Paris Francë.
3. Përfaqësimi i Filmit dhe Kineastëve Shqiptar në Festivalin Nderkombetar i Filmit, Berlinale, Gjermani.
4. Pjesëmarrja e Ansamblit Popullor në koncertin e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Kuvajtit për Kulturën Artin dhe Letrat, Kuvajt.
5. Konkurimi I Filmit “Bota” me regji dhe skenar nga Iris Elezi dhe Tomas Logoreci, në garën e filmit të Huaj_Oscar, USA.
6. Zhvillimi i Ansamblesë EUROIMAGE, në Tiranë.
7. Përfaqësimi i Artistit Shqiptar Eros Dibra, fitues i Onufri, në Residencën e Dysseldorf.
8. Përfaqësimi i artistit Driant Zeneli, në shtëpinë e Artistit në Salzburg
9. Përfaqësimi i Shqipërisë me pjesëmarrjen e Qendrës Kulturore për Fëmijë në Festivalin Ndërkombëtar të 38, të fëmijëve Antalia Turqi;
10. Përfaqësimi dhe pjesëmarrjen e trupës së balëtisë të TKOBAP, në Festivalin e 13-të të Dansit në Novi Sad, Beograd dhe Nis, të Serbisë.
11. Ekspozitë e artit në poster e artistit hungarez Pëterpocs, me vepra të fondit të GKA-së, ekspozuar në Galerinë e Kombëtare të Arteve Prishtinë.

4. Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikostruksione infrastukture në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës.

Rikonstrukcion dhe ndryshim destinacioni i ish laboratorit hidraulik në “Qendër arti-Skena e Re” Nëpërmjet këtij projekti synohet krijim injë teatri bashkëkohor dhe me standarte të larta evropiane. Të bëhet rikonstrukcioni total i këtij objekti dhe adaptimi i tij në salla shfaqjesh bashkëkohore me qëllim zgjerimin e këtij projekti ku synohet:

- Të krijohet një hapësirë e re qytetare
- Të përmirësohen marrëdhëniet me spektatorin duke zgjeruar gamën e aktiviteteve dhe ambienteve të reja artistike
- Të rehabilitohen objektet e mbetura shkretë dhe të destinuara deri tani për shkatërrim kohor si nga ana knstruktive ashtu dhe nga ana arkitektonike dhe instalimeve elektrike e hidraulike për ta kthyer në një objekt bashkëkohor me vlera për komunitetin
- Të ndërtohen sistemet mekanike, elektrike dhe ato të aspirim–kondicionimit
- Të bëhet studimi i akustikës për sallat e shfaqjeve
- Për të rritur kapacitetin e veprimtarive teatrale të Teatrit Kombëtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,